

Universiteti POLIS ka kënaqësinë të shpall të hapur një pozicion pune për një anëtar të personelit në **departamentin e Marketingut**.

Nëse mendoni se jeni i përshtatshëm dhe me përvojë për këtë vend të hapur pune, ju inkurajojmë të lexoni specifikimet e punës si më poshtë.

Kërkesat/Kualifikimet e përgjithshme

- Diplomë universitare në Marketing ose Administrim Biznes
- Përvojë pune në fushën e marketingut
- I gatshëm të punojë edhe në terren.
- Aftësi të shkëlqyera në komunikim.

Lloji i pozicionit të punës

Me kohë të plotë

Përshkrimi i pozicionit të punës

- Të rrisë vizibilitetin e institucionit bazuar në promocionin e vlerave më të mira të tij;
- Të identifikojë target grupet e interesuara dhe tu sigurojë atyre informacion të bollshëm rreth shërbimeve dhe mundësive të ofruara nga U_POLIS;
- Të ruajë dhe zhvillojë më tej marredhëniet pozitive me partnerët shtetërore dhe private si: shkollat e mesme, institucionet homologe, MAS, komunitetin e biznesit, shoqërië civile, etj;
- Të hartojë dhe implementojë strategji marketingu eficiente dhe të mirë-targetuara;
- Të kontribuojë në shtimin e numrit të studenteve universitarë dhe pas- universitarë duke promovuar standartet e mësimdhënies dhe cilësisë së shërbimeve të garantuara nga institucioni;
- Të ndërmarrë iniciativa dhe drejtojë fushata marketingu të shtrira gjatë gjithë vitit akademik sipas një plani pune të hartuar dhe miratur me pare nga stafi drejtues i universitetit;
- Të jetë e disponueshme për të ofruar informacion për çdo individ apo kompani që viziton institucionin;
- Të manaxhojë infomacionin e webpage dhe te kujdeset per updatimin periodik të tij;
- Të konceptojë materiale shtesë promovuese sipas qëllimit dhe destinacionit;
- Të raportojë progresin e bërë dhe rezultatet konkrete tek stafi drejtues

Procedura e Aplikimit

Për të aplikuar për këtë pozicion dërgoni si më poshtë vijon:

- Letër interesi
- Curriculum Vitae

Aplikimet mund të dërgohen në adresën: rektorati@universitetipolis.edu.al

Aplikimi është i hapur deri më datën **10.09.2017, ora 17:00**.

Vetëm kandidatët e përzgjedhur do të kontaktohen për intervistë.

Ju faleminderit!